



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija

Prishtinë/Priština, rr./ul. Bedri Pejani nr./br. 7, tel. +381 (0) 38 225 211; kqz.sekretariati@cec-ko.org; www.cec-ko.org

Tekst Zyrtar

ndryshuar me, 10.08.2009

Në pajtim me Ligjin nr. 03/L-073 (neni 59.3 pika c) për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e vet të mbajtur me datën 04.09.2008, miratoi:

RREGULLOREN E PUNËS SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGEDHJEVE

Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

Rregullorja për punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (më tej “KQZ”) është akt i brendshëm i cili përcakton: thirrjen e mbledhjeve të KQZ-së, kuorumin për punë dhe vendosje të KQZ-së, mbajtjen e mbledhjeve të KQZ-së, procedurat e marrjes së vendimeve, transparencën e punës së KQZ-së, konfliktin e interesave, gjuhët që do të përdoren në punën e KQZ-së, përgatitjen e mbledhjeve të KQZ-së, rregullimin e marrjes së shënimeve në mbledhje, themelimin e këshillave të KQZ-së dhe raportet e tyre me KQZ-në si dhe çështje tjera me interes për punën e KQZ-së dhe Këshillave.

Mbledhjet e KQZ-së

Neni 2

2.1 Mbledhjet thirren nga Kryetari i KQZ-së apo nga së paku katër (4) anëtarë. Njoftimi për mbledhje po ashtu duhet të përfshijë edhe rendin e ditës. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore e deri në shpalljen e rezultateve përfundimtare KQZ-ja mbetet të mbaj mbledhje sipas orarit të përcaktuar.

Kuorumi

Neni 3

3.1 Asnjë mbledhje e KQZ-së nuk do të fillojë ose vazhdojë pa sigurimin e kuorunit të domosdoshëm për mbajtjen e mbledhjes.

3.2 Kuorumi ekziston nëse janë të pranishëm së paku shtatë (7) anëtarë të KQZ-së.

Mbajtja e mbledhjeve të KQZ-së

Neni 4

- 4.1 Mbledhja kryesohet nga Kryetari i KQZ-së.
- 4.2 Në mungesë të Kryetarit mbledhja kryesohet nga anëtari i KQZ-së i autorizuar nga Kryetari.
- 4.3 Kryetari konstaton praninë e së paku shtatë (7) anëtarëve të KQZ-së.
- 4.4 Vëhet në miratim Rendi i Ditës.
- 4.5 Vëhet në miratim raporti nga mbledhja e kaluar.
- 4.6 Të gjitha mbledhjet e KQZ-së regjistrohen në mënyrë elektronike, në mënyrë audio apo vizuale dhe shënimet e takimit mbahen nga Sekretariati i KQZ-së (më tej "SKQZ").
- 4.7 Raporti nga mbledhja përfshinë; ditën e mbledhjes, çështjet që trajtojnë, pjesëmarrësit, diskutimet, propozimet, sugjerimet dhe vendimet.
- 4.8 SKQZ në bashkëpunim me Kryetarin e KQZ-së përcakton renditjen e ulëseve për anëtarët e KQZ-së.
- 4.9 SKQZ siguron një vendtakim të përshtatshëm për mbajtjen e mbledhjeve ku i mundësohet qasja edhe publikut.
- 4.10 Në Mbledhjet e KQZ-së janë të ndaluara; marrja e fjalës pa leje, ndërprerja e folësit, shfrytëzimi i telefonave mobil dhe pirja e duhanit.
- 4.11 Kryetari është përgjegjës për mbarëvajtjen e mbledhjeve të KQZ-së.
- 4.12 Pjesëmarrësit në mbledhje të KQZ-së duhet t'i përmbahen Rregullores së Punës dhe duhet të sigurojnë që të ketë praktika më të mira etike.
- 4.12 Kryetari është përgjegjës për mbarëvajtjen e mbledhjeve të KQZ-së. Në rast të kundërt Kryetari mund t'i përjashtojë pjesëmarrësit tjerë që nuk i përmbahen kësaj Rregulloreje.
- 4.13 Nëse në një rast shkelet Rregullorja e Punës nga anëtarët e KQZ-së, atëherë Kryetari mund të vendos për ta ndërprerë apo shtyrë mbledhjen.
- 4.14 Personat e ftuar nga KQZ-ja, Kryeshefi Ekzekutiv (më tej "KE") apo Zëvendës Kryeshefi Ekzekutiv (më tej "Zv/KE"), këshilltarët nga OSBE-ja kanë të drejtë të japin komente apo opinione në mbledhjet e KQZ-së.

Procedurat e marrjes së vendimeve

Neni 5

- 5.1 Për rregullat zgjedhore, regjistrimin e partive politike dhe çertifikimin e partive politike, shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve, si dhe vendimet lidhur me ankesat që kanë të

bëjnë me shpalljen e rezultateve, KQZ-ja provon të vendosë me konsensus, e kur kjo është e pamundur, atëherë vendoset me dy të tretat (2/3) e votave. Çdo vendim tjetër merret me shumicën e thjeshtë të votave.

5.2 Pas çdo vendimi të KQZ-së Kryetari konstaton shprehimisht vendimin për evidencë të raportit.

5.3 Vendimet e KQZ-së janë përfundimtare dhe nuk i nënshtrohen ankesave përveç kur është e përcaktuar ndryshe me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

5.4 Votimi parimisht bëhet me ngritje të dorës, mirëpo për çështje të caktuara KQZ-ja mund të vendos që votimi të bëhet në mënyrë të fshehtë.

5.5 Votimi bëhet nga anëtarët e KQZ-së me ngritje të dorës, “Për”, “Kundër” dhe “Abstenon”. Në rast se KQZ-ja përcaktohet për votim të fshehtë votimi bëhet përmes fletëvotimeve dhe kutisë së votimit.

Transparenca e punës së KQZ-së

Neni 6

6.1 Mbledhjet janë të hapura për publikun, përveç kur KQZ-ja vendos ndryshe.

6.2 Me rastin e shqyrtimit të çështjeve lidhur me personelin e SKQZ-së, mbledhjet e KQZ-së do të jenë të mbyllura. Për çështje efikasiteti, mbledhja e KQZ-së mund të përfshijë në vete një takim paraprak të mbyllur duke vazhduar më pas me mbledhje të hapur.

6.3 SKQZ-ja duhet t’i informojë mediat dhe opinionin për mbledhjet e KQZ-së, paraprakisht.

6.4 Zëdhënësi i KQZ-së informon mediat dhe opinionin për punën e KQZ-së.

6.5 Anëtarët e KQZ-së mund t’i informojnë mediat dhe opinionin sipas autorizimeve të KQZ - së.

Konflikti i interesave

Neni 7

Anëtari nuk merr pjesë në marrjen e vendimit nga KQZ-ja lidhur me çështjen në të cilën ai ose ajo ose anëtari i tij ose saj i familjes ka interes të natyrës personale ose financiare, e që mund ta vë në dyshim aftësinë e anëtarit për të vepruar në mënyrë të paanshme.

Gjuhët që do të përdoren në punën e KQZ-së

Neni 8

8.1 Gjuhët që përdoren në punën e KQZ-së janë shqipja dhe serbishtja.

8.2 Për të gjitha mbledhjet e KQZ-së do të sigurohet përkthimi në gjuhët e punës, qoftë në mënyrë simultane ose konsektive.

8.3 Të gjitha dokumentet e dorëzuara për shqyrtim nga KQZ-ja përkthehen në gjuhët e punës.

Përgatitja e mbledhjeve të KQZ-së

Neni 9

9.1 Mbledhjet e KQZ-së i përgatitë Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së, ndërsa Rendin e Ditës e propozon Kryetari i KQZ-së.

9.2 KE i SKQZ-së cakton një Zyrtar (në tekst “Zyrtari”) nga radhët e SKQZ-së dhe një Zëvendës në rast të mungesës së Zyrtarit për përgatitjen e mbledhjeve të KQZ-së.

9.3 Njoftimi për mbledhjet e KQZ-së bëhet nga Zyrtari i SKQZ-së.

9.4 Rendi i Ditës dhe materiali duhet t’u dërgohet anëtarëve të KQZ-së së paku 48 orë para kohës së takimit dhe duhet të përfshijë:

- a) Fjalën hyrëse të Kryetarit të mbledhjes
- b) Raportin për punën e SKQZ-së
- c) Raportin për punën e Këshillave
- d) Të ndryshme

9.4 Njoftimi Publik për mbledhje të KQZ-së nga SKQZ-ja duhet të bëhet së paku 48 orë para kohës së takimit

9.5 Një kopje e njoftimit për mbledhje vendoset në hyrje të ndërtesës së KQZ-së dhe në web-faqen e KQZ-së.

9.6 Propozim-vendimet që do të merren nëse dihen më herët duhet qartë të shënohen në Rendin e Ditës së asaj mbledhje.

9.7 Vendimet konfirmohen në mënyrë të shkruar dhe ai dokument duhet të përfshijë:

- a) Logon zyrtare të KQZ-së
- b) Bazën ligjore
- c) Dispozitivin e vendimit
- d) Nënshkrimin e Kryetarit të KQZ-së

Rregullimi i marrjes së shënimeve në mbledhje

Neni 10

10.1 Për çdo mbledhje të KQZ-së përgatitet raporti. Raporti bëhet nga Zyrtari i SKQZ-së. Raporti i mbledhjes duhet të përgatitet dhe t’u shpërndahet anëtarëve 48 orë pas mbajtjes së mbledhjes. Anëtarët e KQZ-së do të kenë në dispozicion 48 orë për dhënien e vërejtjeve dhe komenteve lidhur me raportin.

10.2 Zyrtari i SKQZ-së siguron publikimin e materialeve përkatëse përmes web-faqes zyrtare të KQZ-së dhe atë:

- a) Të gjitha vendimet e KQZ-së
- b) Të gjitha raportet e miratuara nga mbledhjet e KQZ-së
- c) Të gjitha rregullat e miratuara, formularët dhe procedurat përkatëse
- d) Të gjitha materialet tjera siç pajtohet KQZ-ja

10.3 Zyrtari i SKQZ-së siguron kopje në letër sipas kërkesës për ndonjë dokument publik.

10.4 Zyrtari i SKQZ-së siguron arkivimin e duhur dhe dokumentimin e të gjitha materialeve dhe mbledhjet e regjistruara.

10.5 Zyrtari i SKQZ-së është i obliguar të sigurojë se të dhënat e përcaktuara të KQZ-së ruhen në formatin e tyre origjinal, dhe se nuk do të mund të ndryshohen meqë ato janë të mbrojtura me të drejtën autoriale.

Themelimi i këshillave të KQZ-së

Neni 11

11.1 KQZ-ja ka 4 këshilla të përhershëm; Këshillin e Personelit, Këshillin e Buxhetit dhe Prokurimit; Këshillin e Procedurave dhe Këshillin për Operacione Zgjedhore.

11.2 KQZ-ja sipas nevojës mund të themelojë këshilla ad hoc apo grupe punuese.

11.3 KQZ-ja i obligon këshillat që t'i zgjidhin disa çështje të caktuara dhe t'i përcjellin për miratim rekomandimet, raportet, sugjerimet dhe mendimet brenda kohës dhe kushteve që i konsideron të përshtatshme KQZ-ja.

11.4 KQZ-ja mund të pranojë ose refuzojë plotësisht ose pjesërisht çfarëdo raporti apo propozimi të bërë nga këshillat.

11.5 Këshillat e përhershëm përbëhen nga pesë anëtarë nga radhët e KQZ-së dhe të njëjtit do të konstituohen në mbledhjen e parë të KQZ-së.

11.6 Këshillat ad hoc përbëhen nga radhët e anëtarëve të KQZ-së, SKQZ-së e në rast nevoje edhe nga ekspertët.

11.7 Mbledhjet e këshillave udhëhiqen nga kryesuesit e këshillave. Në mungesë të kryesuesit mbledhjen e udhëheq njëri nga anëtarët e këshillit.

11.8 Mbledhjet e Këshillave të KQZ-së i përgatit Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së, ndërsa Rendin e Ditës dhe datën e mbajtjes së mbledhjeve të Këshillave të KQZ-së e përcakton Kryetari i KQZ-së së bashku me Kryesuesit e Këshillave në takimet e tyre të përbashkëta.

Neni 12

Këshilli i Personelit

12.1 Këshilli i Personelit monitoron çështjet e personelit në SKQZ, shqyrton dhe propozon organogramin dhe përkrahimin e detyrave të punës. Zyrtarët e lartë të SKQZ-së dhe zyrtarë nga Divizioni i Zgjedhjeve të OSBE-së marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e Këshillit të Personelit në cilësi të këshilluesit. Sipas kërkesës mund të përzgjidhen nga KQZ-ja edhe ekspertë të tjerë për të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit të Personelit.

12.2 KE i SKQZ-së i raporton Këshillit të Personelit për të gjitha çështjet kadrovike të SKQZ-së.

Neni 13

Këshilli i Buxhetit dhe i Prokurimit

13.1 Këshilli i Buxhetit dhe Prokurimit përgatit propozimin e buxhetit vjetor për KQZ-në, shqyrton gjendjen e buxhetit ekzistues, shqyrton propozimet për prokurim nga buxheti i KQZ-së dhe harton raporte për KQZ-në përkitazi me buxhetin. Zyrtarët e lartë të SKQZ-së dhe zyrtarë nga Divizioni i Zgjedhjeve të OSBE-së marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e Këshillit të Buxhetit dhe Prokurimit, në cilësi të këshilluesit. Sipas nevojës mund të zgjidhen edhe ekspertë të tjerë nga KQZ-ja për të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit të Buxhetit dhe Prokurimit.

13.2 Propozimi për buxhetin e KQZ-së përgatitet në pajtim me nevojat e KQZ-së dhe në përputhje me Ligjin për Financat Publike. Çdo propozim duhet të miratohet nga KQZ-ja para se të dorëzohet në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave.

13.3 Këshilli i Buxhetit dhe Prokurimit i paraqet KQZ-së raporte mujore me shkrim përkitazi me buxhetin e KQZ-së. Këto raporte përfshijnë çdo shpenzim të parashikuar mbi shumën bruto prej 1,000 €. KQZ-ja shqyrton raportet dhe miraton të gjitha shpenzimet e planifikuara para se të realizohen ato.

13.4 KE-ja i SKQZ-së është përgjegjëse për menaxhimin e buxhetit të KQZ-së dhe për zbatimin e vendimeve të KQZ-së.

13.5 Përveç ligjeve, rregulloreve dhe udhëzimeve administrative në fuqi përkitazi me prokurimin që shfrytëzon fondet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK), Këshilli i Buxhetit dhe Prokurimit:

- (a) informon KQZ-në para inicimit të prokurimit të çfarëdo artikulli që kalon shumën bruto prej 1000 €;
- (b) raporton para KQZ-së për të gjitha shpenzimet më të mëdha se shuma bruto prej 100 €.

13.6 KQZ-ja mund të kërkojë arsyetim plotësues nga KE i SKQZ-së ose Këshilli i Buxhetit dhe Prokurimit për çfarëdo shpenzimi(esh) të veçantë.

Neni 14

Këshilli i Procedurave

14.1 Këshilli i Procedurave përgatit procedurat e zgjedhjeve të domosdoshme për zhvillimin zgjedhjeve ashtu siç përshkruhen në legjislacionin përkatës, si dhe të procedurave për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit dhe të shpenzimeve të reprezentacionit dhe për shfrytëzimin e mjeteve të KQZ-së nga personeli i KQZ-së dhe i SKQZ-së, siç janë telefonat (fiks dhe mobil), aparatura teknike dhe automobilat. Zyrtarët e lartë të SKQZ-së dhe zyrtarë nga Divizioni i Zgjedhjeve të OSBE-së marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e Këshillit të Procedurave, në cilësi të këshilluesit. Sipas nevojës, mundet që edhe ekspertë të tjerë të përzgjedhur nga KQZ-ja të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit të Procedurave.

14.2 Cilado procedurë e hartuar nga Këshilli i Procedurave duhet të miratohet nga KQZ-ja para se të hyjë në fuqi.

Neni 15

Këshilli për Operacione Zgjedhore

15.1 Këshilli për Operacione Zgjedhore këshillon dhe ndihmon SKQZ-në në përgatitjen dhe zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës dhe Kuvendet Komunale në Kosovë. Zyrtarët e lartë të SKQZ-së dhe zyrtarë nga Divizioni i Zgjedhjeve të OSBE-së marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e Këshillit për Operacione Zgjedhore, në cilësi të këshilluesit. Sipas nevojës mund të përzgjidhen nga KQZ-ja edhe ekspertë të tjerë për të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit për Operacione Zgjedhore.

15.2. Këshilli për Operacione Zgjedhore në bashkërendim me SKQZ-në ndihmon në përgatitjen e Planit Operativ të Zgjedhjeve dhe jep propozime dhe rekomandime për miratimin nga KQZ-ja të aktiviteteve përgatitore të zgjedhjeve. Këto aktivitete përfshijnë:

- a) çertifikimin e subjekteve politike dhe të kandidatëve për pjesëmarrje në zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale të Republikës së Kosovës;
- b) dizajnimin, miratimin dhe prodhimin me kohë të fletëvotimeve;
- c) identifikimin e qendrave të votimit dhe të vendvotimeve;
- d) krijimin e Listave të votuesve me të gjithë votuesit me zotësi juridike për të votuar në zgjedhjet në Kosovë;
- e) përzgjedhjen, themelimin dhe trajnimin e këshillave të vendvotimeve;
- f) ndërmarrjen e aktiviteteve për të siguruar që njerëzit me aftësi të kufizuara të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës;
- g) bërjen e aranzhimeve të duhura për shpërndarjen dhe kthimin e materialeve të zgjedhjeve;
- h) sigurimin e të gjitha procedurave dhe aranzhimeve për numërimin dhe grumbullimin e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve;
- i) aktivitete të tjera sipas udhëzimeve të KQZ-së.

15.3. Këshilli për Operacione Zgjedhore angazhohet në hartimin dhe zbatimin e Planit Operativ të Zgjedhjeve sipas miratimit nga ana e KQZ-së. Këshilli për Operacione Zgjedhore ndërlidhet me KQZ-në dhe SKQZ-në për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me përgatitjet e zgjedhjeve. Këshilli (pas shqyrtimeve dhe këshillimeve me SKQZ-në) i propozon KQZ-së ndryshime në afatet kohore dhe në ndarjen e resurseve financiare dhe njerëzore për aktivitete të ndryshme zgjedhore të miratuara paraprakisht në Planin Operativ të Zgjedhjeve nga ana e KQZ-së. KQZ-ja do t'ua adresojë të gjitha çështjet e personelit, buxhetit, prokurimit dhe çështjet procedurale që kanë të bëjnë me operacionet e zgjedhjeve këshillave gjegjës për veprim adekuat nga ana e tyre.

Dispozitat përfundimtare

Neni 16

KQZ-ja mund të ndryshojë këtë rregullore sipas procedurës së miratimit.

Hyrja në fuqi

Neni 17

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 04.09.2008 dhe shfuqizon Rregulloren e mëparshme të punës së KQZ-së si dhe Direktivën e KQZ-së nr. 1/2007.

Zait Xhemali

Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve